

Rinovojnë rrugën drejt Manastirit të Rillës



Kryeministri Bojko Borisov inspektoi rehabilitimin e rrugës drejt Manastirit të Rillës. Një mur i gjatë 150 metra forcon segmentin e bllokuar nga një rrëshqitje e dheut në fillim të vitit. Kontrolli u transmetua online në faqen e Borisovit në Facebook.

“Desha që këtu gjithçka të duket si në një kartolinë dhe kur njerëzit vijnë të përulen në këtë vend të shenjtë çdo gjë të jetë perfekte” – tha Kryeministri.

Manastiri i Rillës është një nga monumentet më të rëndësishme kulturore në Bullgari. Ai është përfshirë në listën e trashëgimisë kulturore botërore të UNESCO-s. Është themeluar gjatë shekullit të X nga mbrojtësi qiellor i popullit bullgar Joan Rillski Çudibërësi.